



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 16046 Prot

Shkodër, më 7.8.2025

VENDIM

Nr. 273 datë 7/8 /2025

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.258, DATË 28.07.2025 "PËR DELEGIM
KOMPETENCE".**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 "Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë"; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social", të ndryshuar; ligjit nr.18/2017 "Për te drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"; ligjit nr.75/2019 "Për rininë", i ndryshuar; ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit 9632 date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar; ligjit nr.79/2017 "Për Sportin" të ndryshuar; ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar ne Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr.9270 date 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" të ndryshuar; ligjit nr.8308 date 18.03.1998 "Për transportet rrugore" të ndryshuar; ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin Publik"; ligjit nr.89 datë.22.12.2022 "Për Policinë Bashkiake"; ligjit nr.114/2015 "Për auditin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar; ligjit nr.93/2015 "Për Turizmin" të ndryshuar; Udhezimit nr.30/2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik" të ndryshuar;

VENDOSA:

1. Për një shtesë në vendimin nr.258, datë 28.07.2025 "Për delegimin e kompetencave" të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z.Rudin Beka me detyrë zëvendeskryetar i bashkisë Shkodër, si më poshtë:
Pas pikës 1 të vendimit nr.258, datë 28.07.2025, shtohen pikat 1.1 dhe 1.2, me këtë përmbajtje:
 - 1.1 Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z.Rudin Beka me detyrë zëvendeskryetare i bashkisë Shkodër;
 - për firmosje si nëpunës autorizues.
 - për firmosje si titullar i autoritetit kontraktor për të gjitha procedurat e prokurimit publik.

për të gjithë administratën bashkisë Shkodër.

- për firmosje shkresore që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/ fizik dhe individ, për të gjitha drejtoritë duke përjashtuar strukturat e deleguar sipas vendimit nr.259, datë 28.07.2025 .

1.2. Shfuqizimin e vendimit nr.260, datë 28.07.2025.

2. Zv/Kryetari nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
3. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1.1 do të ushtrohen duke filluar nga data 08.08.2025 dhe përfundojnë me datë 19.08.2025, ora 16.00.
4. Pikat e tjera të vendimit nr.258, datë 28.07.2025 “Për delegimin e kompetencave”, mbeten të pandryshuara.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet z.Rudin Beka dhe administrata bashkisë Shkodër.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

